



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 28 Akti**

**Nr. 44 Vendimi**

**Tiranë, më 23.07.2018**

**V E N D I M**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesuese
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare
<b>Etleda Çiftja</b>	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, dhe në prezencë të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, sot më datë 23.07.2018, ora 11:00, në katin e dytë në Pallatin e Kongreseve zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Arben Nela**, prokuror, zv.drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 179/b dhe D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Arben Nela është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (këtu e më poshtë referuar si “Ligji nr. 84/2016”), specifikon se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë; të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”*.
2. Në bazë të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke qenë se z. Arben Nela është kandidat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar më datë 30 nëntor 2017, me trup gjykues nr. 4, të përbërë nga:  
Xhensila Pine Komisionere;  
Valbona Sanxhaktari Komisionere;  
Etleda Çiftja Relatore.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “**ILDKPKI**”), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “**DSIK**”), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme (këtu e më poshtë referuar si “**GPPP**”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues nr. 4, i shortuar më 30.11.2017 pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (këtu e më poshtë referuar si “**Komisioni**”), me vendimin nr. 1, datë 12.12.2017, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesuese të trupës znj. Xhensila Pine. Po ashtu, të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Më datë 25.05.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Nela, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarinin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.
6. Më datë 04.06.2018, me anë të postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) përbërjen e trupit gjykues.

7. Më datë 08.06.2018, subjekti rivlerësimi bëri kërkesë për njohje me dosjen dhe marrjen e një kopjeje të dokumenteve të dosjes, kërkesë e cila iu pranua në po të njëjtën ditë me anë të postës elektronike.
8. Subjekti i rivlerësimi, më datë 14.06.2018 kërkoi zgjatje të afatit të procedurës për paraqitjen e shpjegimeve apo provave në lidhje me rezultatet e hetimit për një kohë prej 12 ditësh, kërkesë e cila iu pranua, duke i dhënë subjektit dhe 8 ditë shtesë nga ajo fillestarja prej 15 ditësh.
9. Më datë 26.06.2018, subjekti i rivlerësimi, me anë të postës elektronike, solli shpjegimet e tij së bashku me provat, si dhe kërkesën për njohje me raportin e analizës financiare, raport i cili iu dërgua me anë të postës elektronike më datë 17.07.2018. Komisioni administroi provat dhe shpjegimet e subjektit, që u dërguan me anë të postës elektronike dhe në protokollin e institucionit.
10. Më datë 12.07.2018, trupi gjykues nr. 4, me anë të vendimit nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimi, z. Arben Nela, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimi u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 18.07.2018, ora 11:00, në Pallatin e Kongreseve, kati i 2-të, Tiranë.
11. Më datë 13.07.2018, subjekti i rivlerësimi kërkoi të njëjët me rezultatit përfundimtar të hetimit dhe kërkoi të njëjët me rezultatet e hetimit administrativ për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të aftësive profesionale. Komisioni, pasi rishikoi përgjigjet e rezultateve të hetimit, më datë 17.07.2018 njoftoi subjektin e rivlerësimi se rezultati përfundimtar i hetimit ishte i njëjtë me atë që i ishte dërguar më datë 04.06.2018 me anë të postës elektronike.
12. Më datë 18.07.2018 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimi.
13. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimi. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”*, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimi për subjektin e rivlerësimi, z. Arben Nela, vetëm mbi komponentin e vlerësimi të pasurisë, duke mos vendosur mbi kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimi profesional.
14. Në lidhje me kërkesën e subjektit për t’u njohur me rezultatet e hetimit për kriterin e kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale, Komisioni ka kryer hetime të thelluara bazuar vetëm në komponentin e vlerësimi të pasurisë dhe, duke qenë se provat e administruara nga ana e Komisionit kishin arritur nivelin e provueshmërisë për të kaluar barrën e provës, dhe pas kalimit të saj, subjekti i rivlerësimi nuk arriti që me shpjegimet dhe provat e tij të provonte të kundërtën e rezultateve të hetimit, Komisioni në këto kushte merrte vendim vetëm mbi një kriter, atë të vlerësimi të pasurisë, në përputhje me pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, i cili specifikon se: *“Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”*
15. Ky vendim mbi përfundimin e procesit të rivlerësimi për z. Arben Nela merret vetëm mbi kriterin e vlerësimi të pasurisë dhe kjo nuk përbën gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e vlerësimi të figurës dhe atë të vlerësimi profesional.

## II. RAPORTI I HOLLËSISHËM DHE I ARSYETUAR I INSPEKTORATIT TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

16. Me shkresën nr. \*\*\*, datë 17.11.2017, të përbërë nga 23 fletë, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimi, z. Arben Nela, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi \*\*\* dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të

detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” më datë 23.01.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar:

- a. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b. nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c. ka kryer fshehje të pasurisë;
- d. ka kryer deklarim të rremë;
- e. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

### III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

17. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim dhe verbale (*gjatë seancës dëgjimore*) të subjektit të rivlerësimit, datë 26.06.2018 e në vijim deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Nga shqyrtimi i provave të administruara nga Komisioni, për secilin nga asetet dhe të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, rezulton se:

18. **Për deklarimin në lidhje me apartamentin me sip. 99.4 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë**, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. \*\*\*, datë 25.04.2011, në pronësi të Arben Nelës dhe B. N. Apartamenti është blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas kontratës së shitjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.03.2011, në vijim të kontratës paraprake të shitjes datë 19.01.2004. Shuma: 41.251 euro. Pjesa që zotëron: 50 %.

**Me burim krijimi të deklaruar:** i) kursime të krijuara nga të ardhurat e përfituara nga paga e subjektit të rivlerësimit që prej vitit 1998; ii) kursime të krijuara nga paga e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. B. N, si specialiste në Ministrinë e Transportit, si pedagoge në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, si dhe të ardhurat nga licenca e saj individuale për projektim/zbatim; iii) huamarrje shtetases P. H, motra e bashkëshortes, në shumën 25.000 euro, sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.08.2006. Kjo hua është shlyer në vitin 2008. (*Bashkëlidhur të ardhurat e P. H*) Për shlyerjen e huas P. H është përdorur kredia bankare, marrë me kontratën e datës 27.12.2007 me “Raiffeisen Bank” në shumën 1.000.000 lekë, si dhe kursimet e familjes. Kredia bankare është shlyer më 08.01.2010. (*Bashkëlidhur dokumentacioni justifikues, 14 fletë*)

#### 18.1 Për këtë aset subjekti ka paraqitur:

- i. Vërtetim hipotekor nr. \*\*\*, datë 25.04.2011, për apartament banimi me sip. 99.4 m<sup>2</sup> në pronësi të Arben dhe B. N dhe hartë treguese, të noterizuara.
- ii. Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 19.3.2011, çmimi 41.251 euro, me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. + vërtetim hipotekor nr. \*\*\*, datë 18.2.2011, në pronësi të “\*\*\*\*” sh.p.k., i noterizuar + hartë treguese dhe planimetri + dokument identifikimi.

- iii. Kontratë paraprake shitjeje, datë 19.01.2004, me palë blerëse B. Na (Gj.) dhe shitëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. + planimetri dhe 3 mandatpagesa, me vlerë totale 41.335 euro, të noterizuara.
- iv. Kontratë kredie bankare me “Raiffeisen Bank”, datë 27.12.2007, shuma 1.000.000 lekë (*qëllimi për pajisje shtëpiake*), noterizuar + vërtetim i datës 14.01.2010 nga “Raiffeisen Bank” se nuk ka detyrim kredie + kërkesë dhe mandatpagesë e shlyerjes totale të kredisë 847.663 lekë, datë 08.01.2010, të noterizuara.
- v. Kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 16.08.2006, shuma 25.000 euro, mes Arben Nelës dhe P. H.
- vi. Deklaratë e thjeshtë për kthim huaje, datë 21.08.2008, ku konfirmohet likuidimi i shumës 25.000 euro. Noterizimi datë 20.01.2017.
- vii. Dokumente në gjuhën italiane të identitetit, të punës dhe të të ardhurave të shtetasve P. H dhe P. H, të noterizuara, nr. \*\*\* rep., datë 21.01.2017.
- viii. Me vërtetimin nr. \*\*\* rep. të njësisë me origjinalin, subjekti Arben Nela ka noterizuar dhe bashkëlidhur dokumentacion me të dhëna financiare në gjuhën italiane për shtetasen P. H, me kod fiskal \*\*\*për vitet 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2014, si dhe për bashkëshortin e saj, z. P. H, me kod fiskal \*\*\* për vitet 2003 - 2013. Gjithashtu, ka paraqitur dokument të një ndërmarrjeje individuale me nr. administrativ ekonomik \*\*\* në Breshia, datë 09.05.2007, si dhe dokumente identiteti familjare italiane.

## 18.2 Faktet nga hetimi administrativ

- i. Në deklaratën “Vetting” deklarohet apartament me sipërfaqe 99.4 m<sup>2</sup>, në vlerën 41.251 euro dhe se pagesat janë kryer me para në dorë, *cash*, pranë arkës së shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.: në datën 19.01.2004 shuma 8.335 euro; deri më datë 31.12.2005 shuma 8.000 euro dhe deri më datë 31.12.2006 shuma 25.000 euro.
- ii. **Burimet e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting” janë:** i) kursime të krijuara nga të ardhurat e përfituara nga paga e subjektit të rivlerësimit që prej vitit 1998; ii) kursime të krijuara nga paga e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. B. N, si specialiste në Ministrinë e Transportit, si pedagoge në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, si dhe të ardhurat nga licenca e saj individuale për projektim/zbatim; iii) huamarrje shtetasve P. H, motra e bashkëshortes, në shumën 25.000 euro, sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë 16.08.2006.
- iii. Pagesa prej 41.251 eurosh i është bërë me bankë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>1</sup>, jashtë zyrës noteriale, me këste, në “Credins Bank”, respektivisht: i) më 23.12.2004 paguar shuma 22.000 euro; ii) më 08.09.2005 paguar shuma 10.000 euro; iii) më 08.11.2005 paguar shuma 5.000 euro; iv) më 23.11.2005 paguar shuma 4.251 euro.
- iv. Pagesat e kësteve të paguara si më lart nuk janë deklaruar pranë ILDKPKI-së , konkretisht në deklaratimet vjetore 2004 (*shuma 22.000 euro*) dhe 2005 (*shuma 19.251 euro*), sikundër dhe i janë likuiduar shoqërisë së ndërtimit.

---

<sup>1</sup> Me vendimin nr. \*\*\*, datë 02.06.2004, të Gjykatës së Tiranës, është miratuar projekti i bashkimit me përthithje të dy shoqërive “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe me vendimin nr. 131/4, datë 30.06.2004, është miratuar raporti i ekspertit kontabël për bashkimin me përthithje të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k. Kalimin e plotë të trashëgimisë së shoqërisë “\*\*\*\*” te shoqëria përfituese “\*\*\*\*”.

- v. Kredia bankare midis “Raiffeisen Bank” dhe kredimarrësve Arben dhe B. N, e lidhur më datë 27.12.2007, në vlerën 1.000.000 lekë, e cila është lidhur me qëllimin për pajisje shtëpiake, me afat 84 muaj, në fakt është marrë për shlyerjen e kredisë. Subjekti e ka mbyllur këtë kredi më datë 8 janar 2010, duke derdhur shumën prej 847.663 lekësh. Nuk ka dokument justifikues që të vërtetojë se kjo shumë është përdorur për shlyerjen e huas.
- vi. Subjekti i rivlerësimit ka filluar të shfrytëzojë/të jetojë në apartament nga janari i vitit 2006, siç dhe vërtetohet nga letra e OSHEE-së.

**18.3 Komisioni, për vërtetimin e fakteve dhe burimit të të ardhurave,** administroi nga institucionet publike e private, dhe mori deklaramë të vetë subjektit me anë të postës elektronike, si më poshtë:

- i. Me shkresën nr. \*\*\*, datë 17.01.2018, të ZVRPP-së Tiranë konfirmohet apartament me sip. 99 m<sup>2</sup> me nr. \*\*\*, ZK \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, në pronësi të Arben e B. N. Adresa: Rr. “\*\*\*\*”, godina “Alba”, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 19.03.2011, shuma e paguar 41.251 euro, datë regjistrimi 21.08.2013.
- ii. OSHEE-ja, me shkresën nr. \*\*\*, datë 26.12.2017, në përgjigje të shkresës sonë nr. \*\*\*, datë 21.12.2017, bën me dije se në apartamentin në Rr. “\*\*\*\*” është abonent B. N, me kontratë T\*\*\*, hapur më 12.01.2006.
- iii. Me shkresën nr. \*\*\*, datë 07.03.2018, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila konfirmon se kontrata paraprake e shitjes me shoqërinë nga ana e bashkëshortëve Nela është lidhur më datë 19.01.2004 dhe pagesat janë bërë me këste në “Credins Bank”, në vlerën 41.251 euro, të ndara me këste si më poshtë:
  - Datë 23.12.2004, shuma 22.000 euro;
  - Datë 08.09.2005, shuma 10.000 euro;
  - Datë 08.11.2005, shuma 5.000 euro;
  - Datë 23.11.2005, shuma 4.251 euro.
- vii. Vërtetimi, datë 17.01.2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier (viti 2003 - 2005, shuma 1.584.876 lekë).
- viii. Vërtetimi, datë 11.01.2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë (viti 1998 - 2003, shuma 1.914.274 lekë).
- ix. Të ardhura nga paga pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, shuma 808.338 lekë.
- x. Vërtetim për të ardhura nga paga e bashkëshortes si specialiste në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, viti 2000, shuma 102.714 lekë. (*Bashkëlidhur dokumenti justifikues*).
- xi. Vërtetim për të ardhurat nga paga e bashkëshortes si specialiste në MTI, viti 2001, shuma 156.244 lekë.
- xii. Vërtetim për të ardhurat nga paga e bashkëshortes si specialiste në MTI, viti 2002, shuma 293.747 lekë.
- xiii. Vërtetim për të ardhurat nga paga e bashkëshortes si specialiste në MTI, viti 2003, shuma 253.693 lekë.
- xiv. Vërtetim për të ardhurat nga paga e bashkëshortes si specialiste në MTI, viti 2004, shuma 280.281 lekë.
- xv. Shkresat dërguar nga institucionet bankare që konfirmojnë gjendjes e likuiditetit të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes për periudhën që janë shlyer këstet.
- xvi. Analiza financiare e përgatitur nga ana e Komisionit, duke u bazuar në të ardhurat nga burime të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti.

**18.4** Ndërsa subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave dërguar më datë 26.06.2018, si dhe deklaramë në seancën dëgjimore, shpjegoi se:

- i. Këstet për apartamentin janë derdhur sipas kontratës paraprake të lidhur më datë 19.01.2004, derdhur *cash* në arkën e shoqërisë sipas datave në mandatet e arkëtimit të dorëzuara në deklaratën “Vetting”, nga personi i lidhur/ znj. B. N, duke paraqitur një shkresë nga shoqëria “\*\*\*\*”, ku shpjegon se këstet e parashikuara në kontratë janë paguar *cash* në arkën e shoqërisë nga personi i lidhur, znj. B. N, dhe se shoqëria ka vetëdeklaruar të shlyer apartamentin, duke depozituar në bankë, me anë të stafit të saj, pagesat për likuidimin total të tij, pa dijeninë e blerësit.
- ii. “Credins Bank” konfirmon se B. N nuk ishte kliente dhe se për kryerjen e pagesave në favor të palëve të treta nuk kërkonte identifikimin e klientëve rastësor (*personit që paraqitej në bankë për kryerjen e transaksionit*).
- iii. Shuma e huas prej 25.000 eurosh e marrë nga kunata (*motra e bashkëshortes*), P. H, është sjellë në Shqipëri pjesë-pjesë dhe është tërhequr gjatë viteve 2001-2005 nga shteti italian.
- iv. Këstet e para i ka paguar nga kursimet familjare, të mbajtura *cash*, por të padeklaruara në ILDKPKI.
- v. Pronën nuk e ka deklaruar në vitin 2004 dhe 2005 pranë ILDKPKI-së, pasi ajo nuk ishte formësuar akoma.
- vi. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti dërgoi këto prova shkresore: shkresë nr. \*\*\*, datë 07.06.2018, e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; shkresë nr. \*\*\*, datë 12.06.2018, e “Credins Bank”; deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë 08.06.2018, e shtetasve I. K dhe Xh. I; deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë 08.06.2018, e shtetasit A. K; kontratë shitjeje paraprake, datë 19.01.2004; mandatarkëtime, datë 19.01.2004, 20.12.2005 dhe 18.09.2006; tri kontrata shitjeje paraprake të ngjashme të lidhura me persona të tjerë.

## **18.5 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

### **Deklarim i pamjaftueshëm në lidhje me mënyrën e pagesës së vlerës së apartamentit, pasi:**

**18.6** Nga hetimi administrativ rezultoi e provuar se pagesat për këtë apartament janë kryer me bankë, konkretisht pranë “Credins Bank”, vërtetuar me anë të shkresës nr. \*\*\*, datë 07.03.2018, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku i janë bashkëlidhur dhe 4 mandate bankare që janë kryer pagesat pranë “Credins Bank”.

**18.7** Bazuar në gjetjet e Komisionit dhe mospërputhjet në lidhje me mënyrën e pagesës (*cash* apo me bankë), subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës dhe ai solli shpjegime dhe prova, të cilat nuk provuan se nuk kishte qenë personi i lidhur/ znj. B. N, që kishte paguar këstet me anë të bankës.

**18.8** Nuk u provua nga ana e subjektit të rivlerësimit se ishte përfaqësuesi i shoqërisë “\*\*\*\*” që kreu pagesat në bankë.

**18.9** Emri i personit të lidhur/bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. B. N, është i shënuar në mandatin e “Credins Bank”.

**18.10** Pretendimi se është shoqëria “\*\*\*\*” që ka paguar shumën prej 22.000 eurosh më datë 23.12.2004 në bankë, ndërkohë që personi i lidhur/ znj. B. N ka paguar *cash* më datë 19.01.2004 shumën prej 8335 eurosh, është kontradiktor nga ana e subjektit të rivlerësimit.

### **18.11 Deklarim i pamjaftueshëm/i rremë në lidhje me kohën e pagimit dhe vlerën respektive të kësteve. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur dhe ka paraqitur në mënyrë të pasaktë kohën dhe vlerën e paguar në deklaratën “Vetting” 2017, pasi:**

**18.12** Në deklaratën “Vetting” subjekti deklaroi se kishte paguar në datën dhe vlerën si më poshtë:

- i. në datën 19.01.2004 shumën 8.335 euro;

- ii. deri më datë 31.12.2005 shumën 8.000 euro;
- iii. deri më datë 31.12.2006 shumën 25.000 euro.

ndërsa nga hetimi rezultoi e provuar se koha kur ishin paguar këstet dhe vlera e tyre janë:

- i. më datë 23.12.2004 paguar shuma 22.000 euro;
- iv. më datë 08.09.2005 paguar shuma 10.000 euro;
- v. më datë 08.11.2005 paguar shuma 5.000 euro;
- vi. më datë 23.11.2005 paguar shuma 4.251 euro.

**18.13** Mospërputhje midis dy përgjigjeve shkresore të dhëna nga e njëjta shoqëri “\*\*\*\*” sh.p.k, pasi:

- i. Në informacionin e përcjellë Komisionit me anë të shkresës nr. \*\*\*, datë 07.03.2018, shprehet se pagesa për këtë apartament është bërë me anë të bankës, konkretisht: më datë 23.12.2004 është paguar shuma 22.000 euro; më datë 08.09.2005 shuma 10.000 euro; më datë 08.11.2005 shuma 5.000 euro dhe më datë 23.11.2005 është paguar shuma 4.251 euro.
- ii. Ndërsa në informacionin e përcjellë subjektit të rivlerësimit me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 07.06.2018, shprehet se: shuma prej 8.335 eurosh është dorëzuar *cash* në datën e lidhjes së kontratës, më 19.01.2004, arkëtuar te z. A. K, i cili kishte detyrën e punonjësit të zyrës së shitjes. Më tej shprehet se këstet e tjera të pagesës ishin parashikuar të kryheshin deri në fund të vitit 2005 dhe 2006, përkatësisht deri më 31.12.2005 dhe 31.12.2006

**18.14** Qartazi dy shkresat e firmosura nga e njëjta shoqëri kanë përmbajtje të ndryshme dhe bien në kontradiktë me njëra-tjetrën, kontradiktë që nuk u provua nga subjekti i rivlerësimit.

**18.15** Më tej, Komisioni çmon se faktet e shoqëruara me dokumentacion, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shpjegimeve përfundimtare dhe deklarimeve në seancë dëgjimore, nuk provuan të kundërtën e rezultateve të hetimit, pasi këto dokumente kanë vetëm efekt deklarativ dhe jo provues, siç dhe janë mandatet bankare të “Credins Bank” për pagimin e kësteve, të cilat kanë vlerën e një prove të plotë.

**18.16** Në lidhje me kërkesën e subjektit për të thirrur si dëshmitar shtetasit I. K, Xh. I dhe A. K, me qëllim që të provonin faktet që kishte paraqitur subjekti i rivlerësimit, Komisioni vendosi mospranimin e saj, si kërkesë e pabazuar në ligjin nr. 84/2016, neni 49, pika 8 dhe më tej 6 e po të njëjtit nen, pasi për Komisionin fakti që u kërkuar të provohej nga ana e subjektit të rivlerësimit me dëshmitarë, ishte provuar gjatë gjykimit. Më tej, nëse i referohemi Kodit të Procedurës Civile, në rastin e një prove të plotë shkresore nga një subjekt privat për të provuar faktin, marrja e një prove me dëshmitarë nuk lejohet, e thënë kjo sipas parashikimeve të nenit 232 të Kodit të Procedurës Civile, i cili specifikon se: *“Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë”*.

**18.17** Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, jo vetëm që nuk provon të kundërtën e pagimit të këtyre mandateve me bankë nga ana e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit por, përkundrazi, provon se mandatet e arkëtimit bashkëlidhur shkresës nr. 13, datë 07.03.2018, të shoqërisë “\*\*\*\*” janë më se të sakta, provuar kjo dhe me shkresë-përgjigjen dhënë subjektit nga “Credins Bank”. Një fakt të tillë e pranon dhe vetë subjekti i rivlerësimit gjatë gjithë shpjegimeve të tij.

**18.18** Në lidhje me mungesën e burimit financiar të ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e këtij aseti në vitin 2004, Komisioni ka kryer një analizë financiare, duke përfshirë: (i) të ardhurat



nga pagat dhe shpërblimet, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit nga viti 1998 - 2005<sup>2</sup>; (ii) të ardhurat nga pagat të deklaruara nga bashkëshortja e subjektit nga viti 2000 deri më vitin 2005; (iii) huat e marra; (iv) dokumentacionin nga bankat; (v) vlerën e kontraktuar të asetit; (vi) vlerën e kontraktuar minus likuidimin e këstit (detyrimet); (vii) shpenzimet minimale për jetesë; (viii) mandatet bankare të lëshuara nga “Credins Bank” për pagesën e apartamentit.

**18.19** Nga kjo analizë për vitin 2004, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshortja nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor për të vërtetuar pagimin e këstit prej 22.000 eurosh për blerjen e këtij apartamenti (*pagesë e cila është kryer pranë bankës “Credins” më datë 23.12.2004*). Na rezulton se për këtë vit, subjekti i rivlerësimit nuk ka justifikuar me të ardhurat e tij shpenzimet dhe pagesat në shumën **3.187.763** (tre milionë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre ) **lekë**.

**18.20** Për më shumë, tabela e mëposhtme shpjegon qartë se ka pasur mungesë të të ardhurave të ligjshme për blerjen e këtij asemi gjatë vitit 2004.

<b>Analiza financiare për vitin 2004</b>	<b>Vlera në LEK</b>
Të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet	1.170.916
Huaja e marrë	1.267.400
<b>Total mjete monetare të hyra</b>	<b>2.438.316</b>
Pagesat për shpenzime jetese	487.500
<b>Total shpenzime</b>	<b>487.500</b>
Ndryshim mj. monetare gj. 01.01.2004 - 31.12.2004	-2.350.299
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>-399.483</b>
<b>Vlera e kontraktuar e pasurisë (41.251 euro)</b>	<b>5.238.798</b>
<b>Detyrime (22.000 euro)</b>	<b>2.450.518</b>
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>2.788.280</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>-3.187.763</b>

❖ Tabela nr. 1 – Mjaftueshmëria e të ardhurave të ligjshme për vitin 2004.

**18.21 Në lidhje me mungesën e burimit financiar të ligjshëm, që ka shërbyer për blerjen e këtij asemi në vitin 2005,** rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshortja nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor për të vërtetuar pagimin e kësteve në shumë totale prej 19.251 eurosh për blerjen e këtij apartamenti (*pagesë e cila është kryer pranë “Credins Bank”: më datë 08.09.2005 është paguar shuma 10.000 euro; më datë 08.11.2005 shuma 5.000 euro dhe më datë 23.11.2005 është paguar shuma 4.251 euro*). Na rezulton se për këtë vit, subjekti i rivlerësimit nuk ka justifikuar me të ardhurat e tij dhe të personit të lidhur/bashkëshortes shpenzimet dhe pagesat në shumën **2.528.589** (dy milionë e pesëqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë) **lekë**.

**18.22** Për më shumë, tabela e mëposhtme shpjegon qartë se ka pasur mungesë të të ardhurave të ligjshme për blerjen e këtij asemi gjatë vitit 2005.

<b>Analiza financiare për vitin 2005</b>	<b>Vlera në LEK</b>
--	---------------------

<sup>2</sup> Referuar deklaratës para fillimit të detyrës për vitin 2003, subjekti i rivlerësimit në rubrikën “Likuiditete” (gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë apo në huadhënie), nuk ka deklaruar asnjë vlerë.

Të ardhurat nga pagat, shpërblimet dhe kurset e këmbimit	1.215.626
<b>Total mjete monetare të hyra</b>	<b>1.215.626</b>
Pagesë detyrimi shoqërisë së ndërtimit	2.450.518
Shlyerje huaje	1.267.400
Pagesat për shpenzime jetese	487.500
<b>Total shpenzime dhe pagesa</b>	<b>4.205.418</b>
Ndryshim mj. monetare gj.01.01.2005-31.12.2005	881.212
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>-2.108.580</b>
<b>Pagesa për krijim pasurie</b>	<b>420.009</b>
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>420009</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>-2528589</b>

❖ Tabela 2 – Mjaftueshmëria e të ardhurave të ligjshme për vitin 2005.

### 18.23 Baza ligjore

Bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, deklaratimet e subjekti gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- Referuar rezultateve të hetimi administrativ kryesisht, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, për këtë fakt atij i kaloi barra e provës në lidhje me mënyrën e pagesës, kohën e pagesës dhe shumën përkatëse të paguar me anë të kësteve, ndërsa subjekti i rivlerësimit nuk dërgoi prova të tjera të mjaftueshme për të provuar të kundërtën e rezultateve.
- Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë referuar paragrafit 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**19. Për banesën me sip. 136.9 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Tiranë**, regjistruar në ZRPP më datë 10.4.2015 me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, në pronësi të Arben Nelës. Kjo banesë është legalizuar sipas lejes së legalizimit nr. \*\*\*, datë 31.12.2014. Banesa është ndërtuar gjatë viteve 1999 - 2001 nga prindërit e subjektit, me kursimet e tyre (*fillimisht*) si ndërtesë 1-katëshe. Nga kjo pasuri, një sipërfaqe prej 15.3 m<sup>2</sup> (*ambient ndihmës*) i është dhuruar babait të subjektit, z. R. N. Përfundimisht në pronësi të Arben Nelës është regjistruar banesa me sip. 121.60 m<sup>2</sup>, vërtetuar me certifikatën e pronësisë nr. \*\*\*, datë 16.12.2015. Zotëron 50 %. **Burimi i krijimit:** Banesa e ndërtuar gjatë viteve 1999 - 2001 nga prindërit e subjektit me kursimet e tyre, (*fillimisht*) si ndërtesë me 1 kat.

#### 19.1 Faktet nga hetimi administrativ

- Në deklaratën “Vetting” të 2017-ës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar banesë me sip. 136.9 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Tiranë, regjistruar në ZRPP më datë 10.4.2015 me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, në pronësi të Arben Nelës.

- ii. Lidhur me burimin e krijimit deklarohet se banesa është ndërtuar gjatë viteve 1999 - 2001 nga prindërit e tij me kursimet e tyre (*fillimisht*) si ndërtesë 1-katëshe. Nga kjo pasuri, një sipërfaqe prej 15.3 m<sup>2</sup> (*ambient ndihmës*) i është dhuruar babait të subjekti, z. R. N.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka përfituar me legalizim një apartament me sip. 136.9 m<sup>2</sup>, vit ndërtimi 2001, në \*\*\*, Tiranë, ndërtuar pa leje ndërtimi.
- iv. Trualli prej 300 m<sup>2</sup>, mbi të cilin është ndërtuar godina 3-katëshe, është në pronësi të subjekti të rivlerësimit dhe babait të tij, z. R. N.
- v. Edhe pse subjekti i rivlerësimit e ka bërë vetëdeklarimin për herë të parë për legalizimin në vitin 2005, në ILDKPKI këtë godinë 3-katëshe në proces legalizimi e deklaroi vetëm në deklarin vjetor të vitit 2010.
- vi. Në vitin 2013, subjekti i rivlerësimit kërkon pranë ALUZNI-t legalizimin e ndërtimit pa leje me sipërfaqe të bazës së ndërtimit 93 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të përgjithshme të ndërtimit pa leje/shtesës informale 279 m<sup>2</sup>, numri i kateve 3 (tre) dhe sipërfaqe trualli 1090 m<sup>2</sup>.
- vii. Në emër të subjektit të rivlerësimit dhe babait të tij është miratuar dhe lëshuar leja e legalizimit për godinën 3-katëshe, ndodhur në \*\*\*, Tiranë, dhe po kështu është regjistruar në hipotekë më datë 31.12.2014.
- viii. Pas kontratës së pjesëtimit vullnetar të pasurisë në vitin 2015, kati i parë (*i mbetur 121.6 m<sup>2</sup>*) regjistrohet në emër të subjektit (*nga sip.136.9 m<sup>2</sup>, Arben Nela i dhuron babait të tij 15.3 m<sup>2</sup>*) dhe Arben Nela heq dorë përfundimisht nga çdo e drejtë pasurore nga dy katet e tjera, të cilat regjistrohen në emër të R. N dhe dhurohen si më poshtë:
  - ✓ Apartamenti 2, me sip. 136.9 m<sup>2</sup>, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, në emër të R.N. (*Më datë 02.03.2017 është bërë kontrata e dhurimit me kusht dhe më datë 20.03.2017 është bërë regjistrimi i saj në emër të S. N. Rivlerësuar 7.324.150 lekë. Këto veprime janë bërë pas plotësimit të deklaratës së rivlerësimit.*)
  - ✓ Apartamenti 3, me sip. 136.9 m<sup>2</sup>, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, në emër të R. N. (*Më datë 02.03.2017 është bërë kontrata e dhurimit me kusht dhe më datë 20.03.2017 është bërë regjistrimi i saj në emër të R. dhe R. N. Rivlerësuar 7.324.150 lekë. Këto veprime janë bërë pas plotësimit të deklaratës së rivlerësimit.*)
- ix. Në vitin 2013, subjekti i rivlerësimit dhe dy vëllezërit e tij kanë vetëdeklaruar për procesin e legalizimit dy katet shtesë të godinës 3-katëshe, që tregojnë se ata janë bashkëpronarë në pjesë të barabarta të këyre kateve shtesë.

**19.2** Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet publike e private, dhe mori deklarime të vetë subjektit me anë të postës elektronike, si më poshtë:

- i. Shkresën e ZVRPP-së Tiranë, nr. \*\*\* prot., datë 31.01.2018, ku konfirmohet apartament me sip. 121.6 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, ZK \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, në pronësi të Arben Nelës. Adresa: \*\*\*, \*\*\*, Tiranë.
- ii. Sipas ZVRPP-së Tiranë, me shkresën nr. \*\*\*, datë 17.01.2018, të ZQRPP-së konfirmohet se në pronësi të Arben Nelës është një apartament me sip. 121.6 m<sup>2</sup> në ZK \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, dhe sqarohet se origjina e kësaj prone është trualli me sip. 300 m<sup>2</sup>, mbi të cilin është regjistruar godina me 3 kate (*leje legalizimi në emër të Arben dhe R. N*) me 3 apartamente të pjesëtuara.
- iii. Shkresë nga ALUIZNI, së bashku me dokumentacionin shoqërues.
- iv. Shkresë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.
- v. Shkresë lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.
- vi. Shkresë institucioneve bankare për gjendjen e llogarive të subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur/bashkëshortes dhe personave të tjerë të lidhur.
- vii. Dokumente të dërguara nga ana e subjektit me anë të postës elektronike, në prill 2018.
- viii. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike.

### 19.3 Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të dërguara më datë 26.06.2018, si dhe deklarimeve në seancën dëgjimore, shpjegoi se:

#### i. Në lidhje me truallin mbi të cilin është ndërtuar ndërtesa 3-katëshe

Pranon se ka një lapsus nga ana e tij në lidhje me llojin e pasurisë mbi të cilin është bërë ndërtimi, duke sqaruar se sipërfaqja prej 1090 m<sup>2</sup> posedohej nga një shtetas tjetër dhe babai i subjektit ka paguar 30.000 lekë, që ai ta lironte nga posedimi. Ndërsa për sa i përket mungesës së burimit të ligjshëm, subjekti i rivlerësimit shpjegon se babai e tij ka pasur të ardhura mjaftueshëm nga puna e tij si mësues që nga viti 1967, ndërsa nëna ka pasur kursime gjithashtu. Kurse për kalimin i pronësisë mbi truallin prej 300 m<sup>2</sup>, ky kalim është bërë formalisht, duke qenë se dhe vetëdeklarimi i ndërtimit pa leje ishte bërë nga vetë subjekti i rivlerësimit, bashkë me babain e tij, dhe se nuk e ka deklaruar atë në deklaratën “Vetting”, sepse trualli prej 300 m<sup>2</sup> vërtet është regjistruar në Hipotekë në emër të tij dhe babait, por me dhurimin e apartamenteve vëllezërve, trualli ndahet në përpjesëtim me apartamentin, sipas shkresës së dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë.

#### ii. Në lidhje me ndërtesën 3-katëshe në \*\*\*

Subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk e ka deklaruar asetin nga viti 2003 - 2010 pasi ai nuk e posedonte atë, por thjesht ka shprehur vullnetin për të legalizuar këtë banesë bashkë me babin e tij dhe ishte vullneti i prindërve për t'i dhuruar katin e parë të ndërtesës, që përbën shkak për vetëdeklarimin për legalizim, me qëllim që të mos bënin kontratë dhurimi më pas, por ta legalizonin direkt në emër të subjektit të rivlerësimit. Për sa i takon burimit financiar prej 500.000 lekësh për ndërtimin e katit të parë nga prindërit, subjekti i rivlerësimit shpjegon se babai dhe nëna e tij kanë pasur mjaftueshëm të ardhura, pasi babai ka qenë mësues që nga viti 1967, por pa të dhëna nga ISSH, ndërsa nëna ka punuar në fermën e saj, punë për të cilën nuk janë paguar sigurime shoqërore. Në lidhje me mospërputhjet mes vlerës së deklaruar të investuar dhe asaj sipas kostos mesatare të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave, subjekti ka shpjeguar se vlera e llogaritur për ndërtimin e katit të parë është 508.784 lekë, sipas një akt ekspertize teknike-ekonomike të ekspertes V. G dhe jo 3.400.000 lekë.

iii. Ndërsa në lidhje me mundësitë financiare të vëllezërve si persona të tjerë të lidhur, subjekti i rivlerësimit shpjegon se ata nuk konsiderohen persona të lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016, pasi ata nuk kanë hyrë në marrëdhënie juridiko-civile dhurimi apo huaje dhe nuk ka pasur asnjë interes pasuror midis tyre dhe subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht faktit se subjekti i rivlerësimit i konsideron vëllezërit jo si persona të tjerë të lidhur, ai shpjegon se ata kanë qenë të punësuar në kompani private dhe kanë përfituar të ardhurat e tyre për ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë.

### 19.4 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

#### Në lidhje me kohën e blerjes së truallit mbi të cilin është ndërtuar ndërtesa 3-katëshe, si dhe llojin e pronësisë (shtet apo privat)

19.5 Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në lidhje me kohën dhe sipërfaqen e blerjes së truallit dhe pronësinë mbi të, pasi në deklaratën “Vetting” të 2017-ës nuk e deklaroi sipërfaqen e truallit prej 300 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi me babain e tij, ndërsa në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2010 deklaroi: “Sipërfaqja e truallit është blerë nga babai në vitin 1994, nga një person privat, dhe banesa është ndërtuar nga babai me kursime të prindërve”. Kurse, nga praktika e ALUIZNI-t, shkresa nr. \*\*\*, datë 29.12.2014, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, konstatohet se: “Sipërfaqja në zonën kadastrale \*\*\*, \*\*\*, prek pasurinë nr. \*\*\*, vol\*\*\*, fq. \*\*\*, lloj pasurie ‘pyll’, me sip. 831036 m<sup>2</sup>, ref. \*\*\* në pronësi shtet dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 01.08.2012, të Këshillit të Ministrave është vendosur kalimi në pronësi të subjektit dhe të të atit i sipërfaqes së parcelës ndërtimore me sip. 300 m<sup>2</sup>.”. Ndërsa në shpjegimet e tij përfundimtare, subjekti deklaroi se: “Sipërfaqja prej 1090 m<sup>2</sup> posedohej nga një

shtetas tjetër dhe babai ka paguar 30.000 lekë që ai ta lironte nga posedimi”, duke mos paraqitur asnjë dokumentacion ligjor justifikues (kontratë) në lidhje me deklarinimin e tij.

**19.6** Më datë 31.12.2014 është lidhur kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës me nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë 31 dhjetor 2014, ku Arben dhe R. N marrin në pronësi parcelën ndërtimore me sip. 300 m<sup>2</sup>, me çmim 312.000 lekë, ku janë paguar 112.320 lekë dhe shuma 156.000 është paguar me bono privatizimi. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën “Vetting” pronësinë mbi truallin 300 m<sup>2</sup>, vërtetuar kjo me certifikatën e pronësisë nr. \*\*\*, datë 06.02.2015, për truall me sip. 300 m<sup>2</sup> në \*\*\*, Tiranë, në bashkëpronësi të Arben dhe R. N. Një fakt tjetër që vërteton se ky truall, në ½-ën pjesë i takon subjektit të rivlerësimit, është kontrata e pjesëtimit vullnetar, e datës 08.04.2015, midis Arben Nelës dhe R. N, në të cilën citohet se: *“Palët deklarojnë se janë dakord që trualli me sipërfaqe prej 300 m<sup>2</sup> të vazhdojë të mbetet i përbashkët, ku secili zotëron ½ pjesë”*. Bazuar në këto fakte të provuara ligjërisht, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka fshehur pronësinë e ½-ës pjesë të këtij trualli në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

**19.7** Në lidhje me aplikimin/vetëdeklarimin e legalizimit të kësaj ndërtese në vitin 2005, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit duhej të kishte deklaruar këtë aplikim për legalizim në përputhje me nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, i cili specifikon se: *“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI....si më poshtë: “a) pasuritë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil”*.

**19.8** Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën vjetore të vitit 2005 pjesëmarrjen në procesin e legalizimit, por e deklaroi banesën e dhuruar në vitin 2010, duke fshehur gjatë kësaj periudhe të drejtën reale mbi këtë pronë, duke e konsideruar se apartamenti 1, që ka përfituar subjekti, deklarohet i ndërtuar që në vitin 2001.

**19.9** Fakti që subjekti i rivlerësimit ka vetëdeklaruar që nga viti 2005 për këtë ndërtim të bërë pa leje, pavarësisht se ndërtimi ishte formal apo informal, tregon se ai ka shpenzuar para për ndërtimin e kësaj shtëpie, që do të thotë se ai duhet të kishte deklaruar këtë investim apo këtë interes privat që buron nga marrëdhëniet familjare, që në vitin 2005, në përputhje me nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”. Në këto rrethana dhe për sa më lart, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri në posedim të tij, me qëllimin e fshehtësë së burimit që ka shërbyer për ndërtimin e kësaj banese.

**19.10** Si përfundim të sa më lart arsyetuar, Komisionit i rezulton se: Subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën “Vetting” të 2017-ës sipërfaqen e truallit prej 300 m<sup>2</sup> në emër të tij dhe të babait R. N dhe gjithashtu nuk ka deklaruar aplikimin për legalizim në vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, me qëllim që të mos deklaronte burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe subjekti ka vazhduar shtesën e katit të dytë dhe të tretë të banesës në vitet 2011 - 2013, vërtetuar kjo me deklarimet e subjektit dhe dokumentacionin e dorëzuar për legalizim.

## **Në lidhje me personat e tjerë të lidhur/babai dhe nëna e subjekti të rivlerësimit, z. R. dhe znj. F. N**

**19.11** Duke qenë se z. R dhe znj. F. N, prindërit e subjektit të rivlerësimit, i kanë dhuruar subjektit të rivlerësimit katin e parë të kësaj ndërtese, duke e lejuar që të aplikojë për legalizim, atëherë R. N dhe F. N konsiderohen si persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, të konfirmuar prej tyre, kështu që ata kanë detyrimin të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Për më shumë, me babain e tij, z. R.

N, rezulton bashkëpronar në këtë pasuri, pasi ata e kanë regjistruar në ZVRPP Tiranë me të dy emrat, sipas parashikimeve të po të njëjtit nen.

### **Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e truallit dhe ndërtimin e katit të parë të banesës 3-katëshe nga personat e lidhur**

**19.12** Duke qenë se babai dhe nëna e subjektit janë persona të tjerë të lidhur, Komisioni ka kërkuar informacion pranë organeve shtetërore dhe private për të ardhurat e ligjshme të prindërve.

**19.13** Nga vërtetimet e lëshuara nga Zyra Vendore e Tatimeve Tiranë, si dhe Instituti i Sigurimeve shoqërore, prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për ndërtimin e katit të parë të ndërtesës, duke pasur në konsideratë dhe përmirësimet e pronës deri në vitin 2005, kohë kur dhe është deklaruar pranë ALUIZNI-t, provuar kjo me analizën financiare kryer për këtë qëllim. Nga dokumentacioni justifikues ligjor në lidhje me mundësitë financiare për të blerë këtë truall mbi të cilin është ndërtuar shtëpia 3-katëshe, rezultoi se babi i subjektit të rivlerësimit dhe nëna e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për ndërtimin e kësaj banese 1-katëshe së bashku me blerjen e truallit.

**19.14** Rezultoi se të ardhurat neto të babait të subjektit të rivlerësimit janë në vlerë 761.234 lekë, ndërsa për nënën nuk ka të dhëna për të ardhura, përveç një vërtetimi të lëshuar nga subjekti fizik M. H, me NIPT \*\*\*, por të pakonfirmuar nga Drejtoria e Arkivit Qendror, që janë paguar sigurimet shoqërore dhe tatimet. Kështu që, referuar pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, këto të ardhura nuk mund të merren në konsideratë nga ana e Komisionit.

**19.15** Referuar deklaratës noteriale të vitit 2016, në të cilën shprehet se për shtëpinë në Lanabregas ndërtimi ka filluar në vitin 1999 dhe ka përfunduar në vitin 2001, vlera e shpenzimeve ka qenë 500.000 lekë, me të ardhura nga kursimet e dy prindërve. Për të atin, z. R. N, është paraqitur një vërtetim nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 289 prot., datë 06.03.2013, në të cilin shpjegohet se për periudhën 1967 - 2013 (*me përjashtim të viteve 1969 - 1970 dhe 1982*), ka punuar si mësues në disa shkolla të arsimit 8 - 9-vjeçar në qarkun e Tiranës. Nuk është paraqitur asnjë dokument për të ardhurat e përfituara ndër vite. Është sjellë edhe librezja e punës së të atit.

**19.16** Në lidhje me investimin e bërë për ndërtimin e katit të parë nga prindërit e subjektit, ajo është deklaruar 500.000 lekë, por pa paraqitur asnjë provë shkresore që vërteton këtë shumë. Në këto kushte, Komisioni iu referua koston mesatare të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave dhe formularit të vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t, ku viti i ndërtimit ishte 2001, për një sipërfaqe prej 136.9 m<sup>2</sup>, dhe kreu një analizë kostoje për metër katror. Nga analiza e koston rezultoi se **vlera e shpenzuar për ndërtimin e katit të parë është rreth 3.400.000 lekë, duke e konsideruar se për metër katror çmimi është 25.291 lekë.**

**19.17** Nisur nga fakti që trualli është deklaruar i blerë në vlerën 30.000 lekë, si dhe shpenzimet për jetesë dhe shkollim për një familje prej 5 vetash, kostoja mesatare për ndërtimin e banesës referuar EKB-së është 3.400.000 lekë (*por dhe sikur ta marrim të mirëqenë 500.000 lekë, siç deklaron babai i subjekti*), këto kanë qenë të papërballueshme me të ardhurat e ligjshme me dokumentacion justifikues.

### **Në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer për ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë të kësaj banese nga persona të tjerë të lidhur/vëllezërit e subjektit të rivlerësimit**

**19.18** Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpronar me babain për katin e dytë dhe të tretë të banesës deri në momentin që ka nënshkruar kontratën e pjesëtimit vullnetar më datë 08.04.2015. Pra, *de jure* ka qenë bashkëpronar me babain, pasi leja e legalizimit dhe regjistrimi në Hipotekë është bërë në emër të Arben Nelës dhe R. N.

**19.19** Gjatë shpjegimeve të tij, subjekti i rivlerësimit shprehet se kati i dytë dhe i tretë është ndërtuar me të ardhurat e vëllezërve të tij të cilët gjithashtu, sipas këtij deklarimi, janë bashkëpronarë në momentin që kanë vetëdeklaruar në vitin 2013 legalizimin e ndërtesës 3-katëshe, vërtetuar kjo me firmosjen e kërkesës për legalizimin e ndërtimit pa leje, nga të tre vëllezërit në të njëjtin formular. Pra, ka një interes pasuror midis subjektit të rivlerësimit dhe vëllezërve S. dhe R. N.

**19.20** Në këto kushte, në kuptim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, vëllezërit S. dhe R. N konsiderohen bashkëpronarë me subjektin e rivlerësimit, pasi kanë kontribuar financiarisht për ndërtimin e shtëpisë sipas deklarimeve të vetë subjektit. Në këto rrethana, ata konsiderohen persona të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

**19.21** Për këtë arsye, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit, jo vetëm që nuk dërgoi dokumentacion tjetër justifikues, përveç atij të dërguar gjatë hetimit, por me anë të interpretimit të ndryshëm të ligjit argumentonte se pse vëllezërit nuk ishin persona të tjerë të lidhur. Kjo me qëllimin e vetëm për t'iu shmangur justifikimit të burimit të ligjshëm.

**19.22** Më tej, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike dhe deklaratës së pasurisë “Vetting” të vitit 2017, hetimit të ILDKPKI-së dhe provave shkresore të administruara nga ana e Komisionit, analizës financiare të kryer nga ana e këshilltarit financiar, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit, z. R. N (*shih analizën në paragrafët 19.5.7 – 19.5.11*), si dhe vëllezërit e subjektit të rivlerësimit, nuk kanë pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme për të ndërtuar katin e dytë dhe të tretë të banesës 3-katëshe, të cilat, referuar kostove minimale të ndërtimit shkojnë afërsisht 7.400.000 lekë, vërtetuar kjo me anë të përgjigjeve të pyetësorit të datës 21.03.2018 (*përgjigjja e pyetjes 5*), ku subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Vëllezërit e mi, S. N dhe R. N, me kursimet e tyre, si dhe duke u ndihmuar nga prindërit, kanë bërë ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë. Ndërtimi i tyre ka përfunduar në vitin 2013”*. Provat shkresore të dorëzuara nga ana e subjektit të rivlerësimit për të vërtetuar të ardhurat e vëllezërve nuk ishin të mjaftueshme për të mbuluar investimin e kryer në 2 katet e banesës, referuar pamjeve fotografike dhe kostos mesatare të ndërtimit.

**19.23** Në bazë të kontratës së dhurimit nr. 660/133, datë 02.03.2017, personi që ka pranuar dhurimin, z. S. N, i cili ka përfituar katin e dytë me sipërfaqe 136.9 m<sup>2</sup>, ka deklaruar që: *“Në fillim të vitit 2011 kam nisur ndërtimin e katit të dytë, me të ardhurat si avokat dhe të një kredie”*. Kontrata e huas, e datës 29.12.2012, me huadhënës shoqatën e kursim-kreditit “Tirona” dhe z. S. N (*huamarrës*) provon marrjen e një kredie në vlerë 500.000 lekë nga S. N (*në objektin e së cilës përcaktohet se kjo shumë do të përdoret për blerje pajisjesh zyre avokatie*). Në bazë të shkresës nr. 12322/1 prot., datë 12.03.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë rezulton se shtetasi S. N është regjistruar si subjekt “\*\*\*\*” me NIPT \*\*\*, me aktivitet “Industria e ujit mineral dhe të pijeve freskuese”, i regjistruar në QKR më datë 12.07.2010 dhe i çregjistruar nga sistemi tatimor më datë 14.11.2012. Për të ardhurat e realizuara ndër vite nuk ka të dhëna, pasi të gjitha deklaratat janë dorëzuar me zero lek.

**19.24** Shtetasi Selim Nela është i regjistruar me NIPT \*\*\*, me aktivitet “Avokat”, i regjistruar në QKR më datë 10.10.2012, në përgjegjësinë tatimore biznes i vogël me TVSH. Të ardhurat e realizuara ndër vite janë:

- Për vitin 2012, humbje 5037 lekë.
- Për vitin 2013 ka realizuar fitim neto 166.701 lekë, duke eliminuar edhe humbjen paraardhëse, fitimi neto për 2012 - 2013 ka qenë 161.664 lekë.

**19.25** Në bazë të të dhënave të sipërcituara, z. S. N nuk ka pasur të ardhura të justifikuara të mjaftueshme për krijimin e pasurisë (*kati i dytë i ndërtesës në banesën në \*\*\**) në vlerë kostoje ndërtimi afërsisht 3.780.000 lekë, e llogaritur sipas kostove mesatare të ndërtimit për vitet 2005 - 2013 të udhëzimeve të Këshillit të Ministrave për ndërtimin e banesave. Informacioni i dërguar nga subjekti i rivlerësimit nuk është bindës për të faktuar dhe analizuar të ardhurat e vëllezërve dhe kontributin në ndërtimin e banesës deri në vitin 2013.

**19.26** Si përfundim, bazuar në provat që janë mbledhur deri më tani, rezulton se si babai i subjektit të rivlerësimit, z. R. N, ashtu edhe vëllezërit e subjektit, z. R. dhe z. S. N, nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të ndërtuar katin e dytë dhe të tretë të banesës. Subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, pra ai nuk paraqiti dokumentacion justifikues nga burime të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë nga personat e tjerë të lidhur, babai dhe vëllezërit.

### **19.27 Baza ligjore**

Bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, si dhe në ligjin e zbatueshëm, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i. Sipas paragrafit 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të këtij aseti, sipas nenit D, paragrafi 3, të Aneksit të Kushtetutës.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- iv. Personat e tjerë të lidhur, babai dhe vëllezërit, nuk arritën të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

**20. Për apartamentin me sip. 67.6 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*”, Tiranë, në zonën kadastrale \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, pasuria \*\*\*, në pronësi të bashkëshortes, znj. B. N, pjesa takuese 100 %, me vlerë të deklaruar: 52.677 euro. Burimi i krijimit:**

- i. shuma prej 40.000 eurosh e marrë hua shtetases P. H, sipas kontratës së huadhënies nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 21.08.2012 dhe deklaratës së kthimit, e thjeshtë, midis znj. P. H dhe znj. B. N;
- ii. shuma prej 12.677 eurosh nga kursimet familjare (dhe është blerë apartamenti); si dhe
- iii. kursimet familjare; të ardhurat nga paga, nga licenca për projektim/zbatim (nr. Z \*\*\*, datë 5.5.2004, K. \*\*\*, datë 07.04.2016, MK \*\*\*, datë 07.04.2015), si dhe nga paga e bashkëshortit.

#### **20.1 Faktet nga hetimi administrativ**

- i. Në deklaratën “Vetting”, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar një apartament me sip. 67.6 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*”, Tiranë, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. \*\*\*, datë 29.5.2013, me vlerë të blerë 52.677 euro.
- iv. Si burim krijimi, sipas së njëjtës deklaratë: shuma prej 40.000 eurosh i është marrë hua shtetases Pranvera Hasanaj; shuma prej 12.677 eurosh nga kursimet familjare dhe është blerë apartamenti, si dhe kursimet familjare; të ardhurat nga paga, nga licenca për projektim/zbatim (nr. Z \*\*\*, datë 05.05.2004, K. \*\*\*, datë 07.04.2016, MK \*\*\*, datë 07.04.2015), si dhe nga paga e bashkëshortit.
- ii. Më datë 21.08.2012 është lidhur një kontratë huadhënie nr. 3132/659/1, ndërmjet znj. B. N dhe znj. P. H, shuma 40.000 euro, me qëllim kurimin e znj. N., ku nuk evidentohet se si është marrë shuma prej 40.000 eurosh.



- iii. Më datë 14.09.2012, M. Xh deklaroi se ka marrë nga B. N shumën prej 20.000 eurosh, të cilat i ka përdorur për krijimin e një depozite me afat 1-vjeçar, siç vërtetohet nga kontrata me afat e depozitës pranë “Raiffeisen Bank”.
- iv. Subjekti, në përgjigje të pyetjeve të bëra nga Komisioni, deklaroi se në vitin 2013, për shkak të përmirësimit të gjendjes shëndetësore të bashkëshortes, nuk ishte e nevojshme të bëhej transplantimi dhe paratë e marra hua nga shtetasja P. H nuk do të përdoreheshin më për këtë qëllim.
- v. Më datë 03.05.2013, shtetasja M. Xh deklaroi se shuma prej 32.677 eurosh do të likuidohet ditën e nënshkrimit të kësaj deklarate, jashtë kësaj zyre.
- vi. Pasi janë firmosur këto deklarata, më datë 10.05.2013 nënshkruhet kontrata për zëvendësimin e kreditorit midis M. Xh dhe B. N, për një apartament me sipërfaqe 78.04 m<sup>2</sup>, me palë të tretë shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.
- vii. Më datë 20.05.2013 firmoset kontrata e shitjes midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe znj. B. N për shitjen e një apartamenti me sipërfaqe 67.6 m<sup>2</sup>.
- viii. Sipas dokumentacionit për të ardhurat e bashkëshortëve H. (*cituar dokumenti në pikën I*), nga viti 2002 - 2012, rezultojnë të ardhura bruto në shumën rreth 420.000 euro, ose rreth 270.000 euro nga 2007 - 2012.
- ix. P. H ka dhënë dy hua, një në vitin 2006 në shumën 25.000 euro (*e kthyer deri në vitin 2008*) dhe një në shumën 40.000 euro, në vitin 2012 (*e kthyer deri në vitin 2016*).
- x. Edhe huaja e dytë, 40.000 euro, ka kaluar në rrugë informale dhe jo nëpërmjet sistemit bankar ose të paraqitjes së ndonjë dokumenti të deklarimit në kufi nga shtetasja H. apo bashkëshorti i saj.
- xi. Gjithashtu, për shumën pjesore të shlyera nuk është paraqitur dokumentacioni bankar, por ka vazhduar në *cash*.
- xii. Pronari e apartamentit para se ta blinte B. N ka qenë M. Xh, e cila është motra tjetër e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, siç dhe konfirmohet nga vetë subjekti.

**20.2 Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave**, administroi nga institucionet publike e private, dhe mori deklarime të vetë subjektit me anë të postës elektronike, si më poshtë:

- i. Me shkresën nr. \*\*\*, datë 18.12.2017, i është kërkuar informacioni ZVRPP-së Tiranë dhe me anë të shkresës nr. \*\*\*, datë 17.01.2018, të këtij institucioni është konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit ekziston prona e sipërpërmendur e regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Konfirmohet apartamenti me nr. \*\*\*, ZK \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, në pronësi të B. N.
- ii. Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 20.05.2013, ndërmjet B. N dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ap. 67.6 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, çmimi 52.677 euro.
- iii. Kontratë huadhënie nr. \*\*\*, datë 21.08.2012, ndërmjet B. N dhe P. H, shuma 40.000 euro.
- iv. Deklaratë e thjeshtë për kthim huaje, datë 30.09.2016, të shumës 40.000 euro, nga P. H. Noterizimi datë 20.01.2017.

**Për vërtetimin e burimit të të ardhurave**

- v. Kursimet familjare; të ardhura nga paga e bashkëshortes, nga licenca profesionale për projektim/zbatim (nr. Z \*\*\*, datë 5.5.2004, K. \*\*\*, datë 07.04.2016, MK \*\*\*, datë 07.04.2015), si dhe nga paga e bashkëshortit.
- vi. Shkresa e shoqërisë “\*\*\*\*”, datë 21.02.2018, ku konfirmohet se janë kryer pagesat për znj. B. N, si dhe është përcjellë edhe kontrata e punës, e cila nuk përcakton orar pune *part-time*, pagesën e kryer bazuar mbi orët përkatëse të punës, si element kryesor të një kontrate pune.
- vii. Shkresa e dërguar nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj nr. \*\*\*, datë 16.03.2018, konfirmon se “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk ka deklaruar dhe paguar tatim në burim për pagesat e kryera sipas kontratës individuale të punës, të lidhur më datë 01.03.2006 midis kësaj shoqërie dhe punëmarrësit B. N.

- viii. Shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike.
- ix. Gjithashtu, konstatohet se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për shkak të gjendjes shëndetësore, ka qëndruar për periudha të caktuara gjatë vitit për trajtim mjekësor në shtetin italian, dhe në të njëjtën kohë është paguar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

### **20.3 Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të dërguara më datë 26.06.2018 , si dhe deklarimeve në seancën dëgjimore, shpjegoi se:**

- i. Fakti që shuma prej 20.000 eurosh (*pjesë e shumës 40.000 euro*) është depozituar në “Raiffeisen Bank” me nr. 0003561388, bazuar në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë 14.09.2012, provon se kjo hua është materializuar fizikisht, duke u depozituar në bankë.
- ii. Më datë 21.08.2012, personi i lidhur, B. N, ka marrë *cash* nga P. H shumën prej 40.000 eurosh. Shuma prej 40.000 eurosh është mare hua nga B. N te P. H me kontratën nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë 21.08.2012. Shlyerja e huas është bërë në 5 këste nga B. N. Me deklaratën e datës 30.09.2016, shtetasja P. H ka konfirmuar kthimin e huas.

### **20.4 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**20.5** Komisioni, pasi vlerësoi faktet në lidhje me këtë aset, provat e administruara dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në konkluzionin se:

#### **Në lidhje me mënyrën e ardhjes së shumës prej 40.000 eurosh hua nga Italia në Shqipëri**

**20.6** Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë dhe provojë se përse paratë që do të përdoreshin për pagimin e kurimit shëndetësor të bashkëshortes në Itali, do të duhej të silleshin në Shqipëri nga shtetasja P. H, ndërkohë që do të ishte më e lehtë që ato t’i ishin paguar direkt spitalit ose t’i dorëzoheshin në Itali bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, kur të shkonte për kurim.

#### **Në lidhje me pagesën e kryer për blerjen e këtij apartamenti**

**20.7** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka paguar me para në dorë, *cash*, shumën prej 20.000 eurosh znj. M. Xh dhe kjo shumë ishte depozituar nga M. Xh në llogarinë e saj bankare më datë 14.09.2012.

**20.8** Burimi i krijimit të shumës prej 20.000 eurosh është huaja e marrë nga shtetasja P. H (*motra e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit*), sipas deklaratës noteriale të datës 21.08.2012, me qëllim trajtimin mjekësor të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

**20.9** Në përgjigje të rezultateve të hetimit kryesisht, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se “*Në vitin 2013, për shkak të përmirësimit të gjendjes shëndetësore të bashkëshortes, nuk ishte e nevojshme të bëhej transplant dhe paratë e marra hua nga shtetasja P. H nuk do të përdoreshin më për këtë qëllim*”.

**20.10** Nga faktet e pasqyruara më lart, del qartë se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të rremë në lidhje me pagesën e kryer, pasi shuma e huas së marrë prej 40.000 eurosh për trajtim mjekësor më datë 21.08.2012, në fakt është përdorur për blerjen e këtij apartamenti më datë 14.09.2012, ndërkohë që në fakt subjekti i rivlerësimit ishte i sigurt për përmirësimin e gjendjes shëndetësore të bashkëshortes vetëm në vitin 2013. Pra, pagesa e apartamentit është bërë para se të përmirësohej gjendja shëndetësore e bashkëshortes së subjektit, edhe pse marrja e kësaj huaje ishte pikërisht për trajtim mjekësor.

**20.11** Nga hetimi rezulton se personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit më 14 shtator 2012 ka nënshkruar një deklaratë së bashku me shtetasen M. Xh, ku kjo e fundit deklaron

se: “Ka marrë nga B. N një shumë prej 20.000 eurosh, shumë e cila është depozituar pranë ‘Raiffeisen Bank’ sh. a., me qëllim transfertën e kësaj shume për pagimin e shpenzimeve dhe trajtimin për kurimin të znj. B. N në shtetin italian”. Komisioni vlerëson se ky deklaram është i rremë nga ana e znj. B. N dhe znj. M. Xh, dhe është bërë me qëllim që të deklarojë faktet ndryshe nga qëllimi i palëve, pra ka kryer veprime fiktive pa pasur si qëllim sjelljen e pasojave juridike, për këto arsye:

- i. Qëllimi i deklaratës “Për transfertë lekësh në Itali për kurim” nuk përputhet me qëllimin e kontratës së depozitës, e cila është me një afat prej 12 muajsh nga data e depozitimit.
- ii. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk provuan dot me dokumentacion justifikues se kalimi i shumës prej 20.000 eurosh kishte ndodhur nga znj. B. N te M. Xh. Deklarata merret me rezervë për të provuar kalimin e shumës, pasi nuk ka vlerën e një prove shkresore të plotë.
- iii. Nëse shuma e depozituar do të ishte për transfertë, atëherë dhe subjekti vetë apo bashkëshortja e tij mund të kishin depozituar lekët në llogarinë e tyre dhe t’i tërhiqnin në Itali dhe nuk ishte e nevojshme të nënshkruhej një deklaratë.
- iv. Nëse palët kishin qëllim transfertën e parave, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit, minimalisht duhet të kishte nënshkruar një marrëveshje që të reflektonte qëllimin, si dhe për të garantuar se shtetasja M. Xh do t’ia transferonte lekët.

**20.12** Megjithëse subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor në lidhje me huan e marrë te znj. P. H në shumën prej 40.000 eurosh, Komisioni vlerëson se ka dyshime të arsyeshme nga e gjithë marrëdhënia juridike në dukje e krijuar, për këto arsye:

#### ***Mënyra e dhënies së huas dhe ndryshimi i destinacionit***

**20.13** Dhënia e huas është bërë jashtë zyrës noteriale dhe për vërtetimin e faktit të huamarrjes në shumën prej 40.000 eurosh te shtetasja P. H është depozituar kontrata e huadhënies nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.08.2012. Sipas deklaratave periodike vjetore, fillimisht qëllimi i marrjes së kësaj huaje ka qenë për të përballuar shpenzimet e trajtimit mjekësor të bashkëshortes së subjektit në Itali ( për të cilat subjekti referon në përgjigjet e tij se është trajtuar falas në spitalin civil në Breshia), por duke qenë se nuk ishte e nevojshme të përdreshin për trajtim mjekësor, janë shtuar edhe 12.677 euro nga kursimet familjare dhe është blerë apartamenti.

#### ***Mënyra e kthimit të huas***

**20.14** Subjekti i rivlerësimit deklaron se huaja në shumën 40.000 euro është shlyer gjatë viteve 2013, 2014, 2015 dhe likuiduar përfundimisht në vitin 2016. Kjo huamarrje dhe kthimi i saj, të marra nga shtetasja P. H, rezultojnë se nuk janë kryer përmes metodave të njohura ligjore, që do të provonin dhe veprimin e kryer nga palët, qoftë dhe për të vërtetuar se sa lekë janë marrë dhe sa lekë i janë kthyer, në kushtet kur njëra palë mund të abuzojë, duke mos pasur një provë të plotë ligjore.

#### ***Kalimi i shumës prej 40.000 eurosh te shtetasja M. Xh (motra e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit)***

**20.15** Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë dokument ligjor provues që vërteton kalimin e kësaj shume te znj. M.Xh. Me përjashtim të deklaratës noteriale, fakti i huamarrjes nuk provohet me asnjë provë, nga sistemi bankar apo deklarime në kufi, ashtu si edhe fakti i shlyerjes.

## ***Mospërputhje deklarimesh në lidhje me kohën kur është paguar shuma 20.000 euro te znj. M. Xh***

**20.16** Sipas deklaratës midis znj. M. Xh dhe znj. B. N, nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë 03.05.2013, palët bien dakord se apartamenti me sipërfaqe totale 78.04 m<sup>2</sup>, (*ndryshime në sipërfaqen e deklaruar të këtij apartamenti*) i ndodhur në rrugën “\*\*\*” do të blihet nga znj. B. N dhe likuidimi do të bëhet në këtë mënyrë:

- shuma prej 32.677 eurosh do të likuidohet ditën e nënshkrimit të kësaj deklarate, jashtë zyrës noteriale;
- shuma prej 20.000 eurosh është kaluar nëpërmjet deklaratës noteriale, pa numër, datë 14.09.2012.

Ndërsa subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit të datës 21.03.2018, konkretisht pyetjes nr. 7, deklaron se shuma prej 20.000 eurosh i është dhënë shtetases M. Xh (*person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit*) deklaruar para noterit më datë 14.09.2012, me qëllim transfertën e kësaj shume për pagim shpenzimesh mjekësore, ndërkohë që kjo shumë, në të njëjtën datë, është vendosur në depozitë me afat 1-vjeçar në “Raiffeisen Bank” me interes vjetor 2.7 %. Ky fakt nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklarinimin periodik të vitit 2012, dhe shuma prej 20.000 eurosh nuk është deklaruar si e kaluar për M. Xh, provuar kjo me deklaratën noteriale të datës 03.05.2013, kur kjo shumë për të gjithë periudhën, që nga marrja, ka qenë në posedimin e kësaj të fundit.

## **Në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti**

**20.17** Komisioni, pasi analizoi për sa më lart në lidhje me këtë aset, konkludon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti, duke pasur parasysh kohën e shlyerjes së shumës prej 12.500 eurosh në momentin e firmosjes së kontratës së zëvendësimit të kreditorit.

## **20.18 Baza ligjore**

Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku dhe duke parë edhe deklaratat vjetore të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- iv. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të këtij aseti, sipas nenit D, paragrafi 3, të Aneksit të Kushtetutës.
- v. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur dhe evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- vi. Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## **21. ARSYETIMI LIGJOR DHE ANALIZA E ASETEVE DHE TË ARDHURAVE SË BASHKU**

Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (iv) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike; (v) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim që të kuptohet

më qartë raporti midis aseteve të deklaruara dhe të ardhurave të ligjshme, si dhe analiza ligjore e veçantë për çdo aset, konkludon se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke bërë deklaram të rremë, duke fshehur për të gjitha pasuritë burimin e vërtetë të krijimit të këtyre pasurive, duke bërë deklaram jo të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe, për rrjedhojë, rezulton se ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë.
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të pasurive të përmendura në këtë vendim, sipas nenit D, paragrafi 3, të Aneksit të Kushtetutës.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur dhe evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.

## **22. BASHKËPUNIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT GJATË HETIMIT, SIPAS NENIT 48 TË LIGJIT NR. 84/2016**

Gjatë të gjitha fazave të hetimit, ky Komision ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit në lidhje me gatishmërinë për të kthyer përgjigje, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

## **23. KONKLuzioni PËRFUNDIMtar**

Në përfundim të procesit të rivlerësimit për subjektin Arben Nela vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar analizës së sipërcituar për pasuritë dhe të ardhurat, veç e veç, si dhe të marra së bashku, konkludon se subjektit të rivlerësimit, z. Arben Nela, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe në nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Nela, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

4. Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 23.07.2018.

**Kryesues**  
**Xhensila PINE**

**Anëtar**  
**Valbona SANXHAKTARI**

**Relator**  
**Etleda ÇIFTJA**

**Sekretare gjyqësore**  
**Anisa DUKA**